



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 128

Tiranë – E mërkurë, 28 shtator 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 22.9.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.....
	16129
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 421, datë 19.7.2022	Për mbështetjen nëpërmjet kompensimit financiar për mjekët specialistë të emëruar larg vendbanimit të tyre për një periudhë 3-vjeçare, në bazë të detyrimit kontraktor me ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë.....
	16129
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 218, datë 1.9.2022	Mbi kërkesën e shoqërisë “Bindi” sh.p.k. për rinovimin e licencës, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017.....
	16130
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 219, datë 1.9.2022	Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 240, datë 21.12.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Erdy Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kalis’, me kapacitet të instaluar 2138 kw”.....
	16131
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 229, datë 12.9.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, dhe çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për periudhën 1.8.2022–31.12.2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.....
	16132
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 230, datë 12.9.2022	Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, për periudhën 2.7.2022 deri më 31.12.2022.
	16134
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 231, datë 12.9.2022	Mbi shtyrjen e vendimarrjes së Bordit për kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për transferimin e aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and instalation of transmission meter/data center” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.....
	16149

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 232, datë 12.9.2022	Mbi një ndryshim në vendimin e licencimit të shoqërisë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kw.....	16150
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Pashk Abazi.....	16151
	Korrigjim në tabelat e munguara të aneksit nr. 2 të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 95, datë 9.5.2022, “Për miratimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 78, datë 24.5.2022.....	16151
	Ndreqje gabimi në vendimet e Bordit të ERE-s nr. 75, 76, 77, datë 13.4.2022, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 65, datë 29.4.2022.....	16159

**VENDIM**

Nr. 620, datë 22.9.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/ NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 6, të vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, para paragrafit të fundit shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Presidenti i Republikës ka të drejtë të ketë këshilltarë të jashtëm. Paga e tyre mujore përcaktohet nga Presidenti, në masën deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2022, përballohen nga fondet e institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

UDHËZIM

Nr. 421, datë 19.7.2022

PËR MBËSHTETJEN NËPËRMJET KOMPENSIMIT FINANCIAR PËR MJEKËT SPECIALISTË TË EMËRUAR LARG VENDBANIMIT TË TYRE PËR NJË PERIUdhË 3-VJEÇARE, NË BAZË TË DETYRIMIT KONTRAKTOR ME MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR ÇËSHTJET E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 11/1, e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 11.8.2011, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, në strukturat e tjera të forcave të armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Mjekët, pas përfundimit të specializimit në spitalet universitare, në bazë të detyrimit kontraktor me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale emërohen sipas nevojave të sistemit shëndetësor për një periudhë trevjeçare.

2. Mjekët e përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi, të cilët emërohen larg vendbanimit të tyre përfitojnë një kompensim në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

3. Mjekët e përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi duhet të vërtetojnë që ushtrojnë detyrën larg vendbanimit të tyre, duke depozituar pranë institucionit shëndetësor ku janë emëruar një vërtetim banimi nga institucionet kompetente sipas ligjit.

4. Mjekët e përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi, të cilët janë emëruar dhe kanë filluar detyrën para datës 1 korrik 2022 do të jenë përfitues të kompensimit për kosto jetese për pjesën e mbetur të kohëzgjatjes së kontratës 3-vjeçare.



5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore dhe drejtoritë rajonale të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, si dhe institucionet shëndetësore publike për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 218, datë 1.9.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“BINDI” SHPK PËR RINOVIMIN E
LICENCËS, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 170,
DATË 26.10.2017**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, si dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1504/1 prot., datë 29.8.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Bindi’ sh.p.k. për rinovimin e licencës, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Bindi” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 387, seria T17, në veprimtarinë e

tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1385/3 prot., datë 18.8.2022, ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence.

- Në zbatim të nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i licencuari duhet të paraqesë në ERE një aplikim për rinovim licence jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë “Bindi” sh.p.k. për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur në afat.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin lidhur me nenin 9, pika 1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; nenin 9, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”; nenin 9, pika 3, gerrat “a”, “b” dhe “d”, si dhe nenin 9, pika 4.8, gerrat “a”, “b” dhe “c”.

Në këtë aplikim mungon dokumenti, si më poshtë vijon:

Neni 9, pika 3:

- Germa “c”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dhe deklaratën e ortakut të vetëm të saj, ku të jepet miratimi i tij për të mbështetur veprimtarinë e shoqërisë “Bindi” sh.p.k. nëpërmjet të ardhurave të tij personale, sipas kapitalit të deklaruar nga vetë shoqëria.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Bindi” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 219, datë 1.9.2022

**MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË
BORDIT TË ERE-s NR. 240, DATË
21.12.2020, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘ERDY ENERGY’ SHPK,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
‘KALIS’ ME KAPACITET TË INSTALUAR
2138 kw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1504 prot., datë 29.8.2022, “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr.

240, datë 21.12.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Erdy Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kalis’, me kapacitet të instaluar 2138 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 240, datë 21.12.2020, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Erdy Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kalis”, me kapacitet të instaluar 2138 kw, për një afat 30-vjeçar. Referuar pikës 4 të këtij vendimi, shoqëria ka detyrimin që pas përfundimit të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (datë 25.4.2022), të depozitojë lejen me afate të rifreskuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

- Referuar përcaktimeve të pikës 4, të vendimit nr. 240/2022, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 389 prot., datë 18.3.2022, duke i kërkuar informacionin përkatës mbi aplikimin për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujor në kuadër të plotësimit të kushtit të këtij vendimi.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 389/1 prot., datë 18.4.2022, shoqëria ka bërë me dije se ka aplikuar pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) dhe është në pritje të shqyrtimit të kërkesës së saj, ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1340 prot., datë 29.7.2022, shoqëria ka depozituar vendimin dhe lejen e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin (KBU), për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kalis”. Në këtë leje përcaktohet se periudha e vlefshmërisë është 5 vjet dhe hyn në fuqi pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.

- Sikurse publikuar në regjistrin e subjekteve që disponojnë leje/autorizim të vlefshëm për përdorim burimi ujor për prodhim hidroenergjie, të aksesuar *online* në adresën: www.ambu.gov.al, rezulton se data e përfundimit të lejes së përdorimit të burimit ujor për HEC “Kalis” është 4.7.2027.

- Për sa më sipër vlerësohet që të ndryshohet kushti i vendosur në pikën 4 të vendimit nr. 240/2020, duke i lënë shoqërisë detyrimin që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor, jo më vonë se data 4.7.2027.

- Gjithashtu, për qëllime të unifikimit të kushteve të vendimit nr. 240/2020 dhe vendosjes së një afati, për sa i përket kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi, vlerësohet rishikimi i pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.



- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti administrativ, me nismën e vet organit, që ka nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2, 3 dhe 4 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 240, datë 21.12.2020, ndryshojnë si vijon:

“2. Shoqëria “Erdu Energy” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Librazhd, jo më vonë se data 21.10.2025.

3. Shoqëria “Erdu Energy” sh.p.k. të depozitojë në ERE informacion/dokumentacion mbi statusin e aplikimit për heqjen nga fondi pyjor bazuar në komunikimet shkresore me autoritetet përgjegjëse, brenda 3 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

4. Shoqëria “Erdu Energy” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor, jo më vonë se data 4.7.2027.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 229, datë 12.9.2022

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN GUSHT 2022, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV, DHE ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR PERIUDHËN 1.8.2022–31.12.2022, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 20/10/6 kV

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.9.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1528/3 prot., datë 9.9.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, dhe çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për periudhën 1.8.2022–31.12.2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me shkresën nr. 6093 prot., datë 6.9.2022, protokolluar me tonën me nr. 1441/1 prot., datë 8.9.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 31,37 lekësh/kwh për muajin gusht 2022, ku janë përfshirë edhe kostot e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF).

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 6084 prot., datë 6.9.2022, protokolluar me tonën me nr.



1441/2 prot., datë 8.9.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18,34 lekësh/kwh për muajin gusht 2022, ku janë përfshirë edhe kostot e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga FMF-ja.

- Mbështetur në nenin 6, pika 3, dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar: tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Kostot e disbalancave do të llogariten dhe faturohen nga shoqëria, në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut të Balancimit dhe akteve të tjera në fuqi.

- Në lidhje me komponentët e tjerë të përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF, për muajin gusht 2022, evidentojmë, se, në përputhje me nenin 9 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF-ja, për muajin gusht 2022, janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlogaritjet e ERE-s, për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja, për muajin gusht 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse, si vijon:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësish së Fundit për nivele tensioni për muajin Korrik 2022				
KORRIK 2022		Nivelet e tensionit		
		35 kV	20/10/6 kV	
	Njësia	Çmimi	Çmimi	
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	26.93	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.81	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësish së Fundit	Leke/kWh	1.06	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh	31.20	18.26

- Elementet përlogaritëse të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF-ja mbeten të pandryshuar prej disa muajsh, ERE me shkresën nr. 1514 prot., datë 2.9.2022, ka kërkuar informacion nga shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., nëse çmimi i shitjes do të vijojë të mbetet i pandryshuar prej 12 lekësh/kwh, si parashikohet në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme së shoqërisë KESH sh.a. Duke qenë se nuk ka njoftim nga shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për ndryshim të çmimit prej 12 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivel tensioni 20/10/6 kV, vlerësohet të vijohet me llogaritjet për periudhën e mbetur të vitit 2022.

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga FMF-ja do të jetë:

- 31.29 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, për muajin gusht 2022;

- 18.26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, për periudhën 1.8.2022–31.12.2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2022, prej 31.29 lekësh/kwh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;

2. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për periudhën 1.8.2022–31.12.2022, prej



18.26 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

3. Çdo ndryshim në elementet përbërëse të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të miratuar në pikën 2 të këtij vendimi, për periudhën pas hyrjes në fuqi, përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi.

4. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 230, datë 12.9.2022

**MBI MIRATIMIN E KONTRATËS PËR
SHITBLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SHA
DHE OST SHA, PËR MBULIMIN E
HUMBJEVE NË SISTEMIN E
TRANSMETIMIT, PËR PERIUdhËN
2.7.2022 DERI MË 31.12.2022**

Në zbatim të neneve 16, 20, germa "h", 47, 56 germa "f", si dhe 90, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; pjesës I, nenit 4, pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike"; VKM-së nr. 256, datë 29.4.2022, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të

Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike"; kapitullit V të "Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 139, datë 15.8.2016, të ndryshuar; "Kodi i Transmetimit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 11.4.2022; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.9.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1528/2 prot., datë 9.9.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike "Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit", konstatoi se:

- Me shkresën nr. 1147/1 prot., datë 11.8.2022 shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a. kanë dërguar në ERE kërkesën për miratimin e kontratës me nr. 4670 prot., datë 27.7.2022 (OST sh.a.) dhe nr. 3635 prot., datë 27.7.2022 (KESH sh.a.), "Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit", të miratuar dhe nënshkruar ndërmjet palëve OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- VKM-ja nr. 584, datë 8.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike", të ndryshuar, ka shpallur gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri në 31 dhjetor 2022.

- Neni 4, pika 7, e pjesës I, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", përcakton, se: "Ky vendim është i zbatueshëm edhe për përballimin e situatës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, sipas nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, 'Për sektorin e energjisë elektrike', të ndryshuar."

- Në këto kushte, Palët kanë rënë dakord të lidhin kontratën e sipërcituar në zbatim të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe



furnizimit me energji elektrike”, e cila ka vendosur që gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizim, shoqëria publike e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Operatorin e Sistemit të Transmetimit me të gjithë sasinë e nevojshme, për mbulimin e humbjeve, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike. Kontrata ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, negociohet nga palët dhe miratohet nga ERE.

- Kontrata, objekt miratimi, ka gjithsej 19 nene dhe 2 anekse dhe është hartuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike; si dhe Kodit të Transmetimit.

- Qëllimi i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe i detyrimeve të palëve për skedulimin, deklarimin dhe garantimin në sasinë dhe cilësinë e kërkuar të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, për periudhën kohore 2.7.2022–31.12.2022.

- Në kontratë përcaktohen edhe detyrimet e palëve, ku: blerësi do t'i paraqesë shitësit, brenda orës 14:00, programin e ditës në avancë me bazë orare të ngarkesës për nevojat për energji për mbulimin e të gjithë sasisë së humbjeve në sistemin e transmetimit, në përputhje me aktet rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe sipas formatit të parashikuar në anekset e kësaj kontrate. Dhe nga ana tjetër, shitësi do të livrojë dhe blerësi do të pranojë sasinë e energjisë elektrike të konfirmuar nga shitësi për blerësin, sipas parashikimeve të nenit 3 të kësaj kontrate, ose sasi të rëna dakord me shkrim midis shitësit dhe blerësit. Në rast se nuk do të ketë dakordësi midis palëve, atëherë do të zbatohet programi me vlerë më të ulët.

- Sa i përket çmimit të përdorur nga palët në këtë kontratë, në nenin 5, “Çmimi”, përcaktohet, se: “Blerësi paguan shitësin për energjinë elektrike të blerë për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike”, sikurse

përcaktohet në nenin 13, pika 1 e VKM-së nr. 456/2022.

- Në kontratë janë trajtuar dhe shumë elemente të tjera me rëndësi për mirëfunksionimin e një marrëdhënie kontraktuale ndërmjet palëve. Si të tillë në kontratë janë përcaktuar modalitetet që kanë të bëjnë me detyrimet kryesore për furnizimin me energji elektrike, livrimi, matja transmetimi dhe risku i energjisë elektrike në rrjet, lëshimin e faturës për shërbimin e kryer, çmimi i aplikueshëm i cili parashikohet sipas vendimit të ERE-s, në lidhje me këtë shërbim, kushtet e pagesave, po ashtu janë trajtuar aspekte të mosperformacës, për shkak të forcës madhore dhe reagimet ndaj saj, garancitë dhe mbështetja e kredisë, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, si dhe personat e palëve përfaqësuese në këtë kontratë.

- Aneksi 1 i kësaj kontrate paraqet raporttraktordin midis palëve të sasisë së energjisë elektrike të livruar nga KESH sh.a. tek OST sh.a., në datën dhe orën e caktuar, si dhe nënshkrimi nga palët përfaqësuese të kësaj kontrate.

- Aneksi 2 paraqet konfirmimin e palëve për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, lidhur me dërgimin dhe pranimin e energjisë elektrike. Referencat e këtij aneksi janë: fillimi i livrimit, mbarimi i livrimit, sasia e livruar (mwh), çmimi i shitjes (lekë/mwh), si dhe vlera totale (lekë).

- Kohëzgjatja e kësaj kontrate është për periudhën 2.7.2022–31.12.2022, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 456/2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe VKM-së nr. 584/2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë publike të prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit për periudhën



kohore 2.7.2022 deri në datën 31.12.2022 (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë të shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 2.7.2022 deri më 31.12.2022.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund

ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



Nr. 4670 prot. Tiranë, më 27.07.2022



Nr. 3635 prot. Tiranë, më 27.07.2022

KONTRATË

PËR

SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E

HUMBJEVE

NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT



E lidhur sot më datë _____.2022, ndërmjet:

Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a., shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në: Bllokun “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i J61817005F, e përfaqësuar nga Z. Ergys Verdho, Administrator i Shoqërisë KESH-sh.a., që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

dhe

Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST-sh.a., shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 31935, dt. 14.07.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në: Autostrada Tiranë-Durrës, km 9, Kashar, Yrshek, Tiranë, Shqipëri, me NIPT Nr. K42101801N, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë **Z.Skerdi DRENOVA**, që më poshtë quhet “Blerësi”,

Baza ligjore:

- a) Ligji Nr. 43/2015, date 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- b) VKM Nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”;
- c) VKM Nr. 584 datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjences në furnizimin me energji elektrike” (i ndryshuar);
- d) Rregullat e Përkohëshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e ERE Nr.139/2016, i ndryshuar;
- e) Kodi i Transmetimit, miratuar me Vendimin e ERE Nr. 63 dt.11.04.2022;
- f) Vendimi i ERE Nr. 99, datë 17.06.2016, “Mbi miratimin e Licensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike”;
- g) Vendimi i ERE Nr. 134, dt. 06/09/2017 “Mbi liçensimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST-sh.a. në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”;
- h) Vendimi i ERE Nr. 253, datë 21.12.2021 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2022”

Në kushtet kur:

- VKM Nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ka vendosur që gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizim, shoqëria publike e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Operatorin e Sistemit të Transmetimit me të gjithë sasinë e nevojshme, për mbulimin e humbjeve, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike.
- Kontrata e sipërpërmendur ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, negociohet nga palët dhe miratohet nga ERE.



- Me VKM Nr. 584 datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” (i ndryshuar), është shpallur gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri në 31 Dhjetor 2022

Palët bien dakord lidhur me përbajtjen e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike në kuadër të përbushjes së detyrimit të parashikuar për shërbim publik si më poshtë vijon:

NENI 1 QËLLIMI I KONTRATËS

Qëllimi i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve për skedulimin, deklarimin dhe garantimin në sasinë dhe cilësinë e kërkuar të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, për periudhën kohore 02.07.2022- 31.12.2022.

NENI 2 PËRKUFIZIMET DHE NDËRTIMI

1. **Përkufizimet:** Termat e përdorur në Kontratë do të kenë kuptimet e dhëna në Ligjin Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM Nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; Rregullat e Përkohëshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e ERE Nr.139/2016, i ndryshuar; Kodin e Transmetimit, miratuar me Vendimin e ERE Nr. 63 dt.11.04.2022;
2. **Interpretimi:** Titujt dhe nëntitujt janë vetëm për lehtësi dhe nuk prekin interpretimin e Kontratës.
3. **Referencat në Kohë:** Referencat në kohë do të jenë sipas Kohës Qendrore Evropiane (CET).
4. **Perputhja me Aktet nënligjore dhe Rregullat e Tregut:** Kjo Kontrate hartohet në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin e energjisë elektrike. Në rast se ndonjë parashikim në këtë Kontratë bie në kundërshtim me ndonjë parashikim në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, atëherë, ky parashikim në kontratë konsiderohet i pavlefshëm/pazbatueshëm dhe marrëdhënia rregullohet sipas parashikimeve të aktit në fuqi.

NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERËSIT

Blerësi do t'i paraqesë shitësit, brenda orës 14:00, programin e ditës në avancë me bazë orare të ngarkesës për nevojat për energji për mbulimin e të gjithë sasisë së humbjeve në sistemin e transmetimit, në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe sipas formatit të parashikuar në Aneksin e kësaj kontrate.

NENI 4 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

Shitësi do të livrojë dhe blerësi do të pranojë sasinë e energjisë elektrike të konfirmuar nga shitësi për blerësin sipas parashikimeve të nenit 3, ose sasisë e rëna dakord me shkrim midis Shitësit dhe Blerësit. Në rast se nuk do të ketë dakordësi midis palëve, atëherë do të zbatohet programi me vlerë më ulët.

**NENI 5
ÇMIMI**

Blerësi paguan Shitësin për energjinë elektrike të blerë për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, me cmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike.

**NENI 6
DETYRIMET KRYESORE PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE**

1. **Përgjegjësia për balancimin e energjisë:** Shitësi dhe Blerësi janë subjekte të rregullave në fuqi për balancimin dhe për rrjedhojë, përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.
2. **Livrimi dhe Pranimi:** Shitësi do të programojë, shesë dhe livrojë, ose do të bëjë të mundur të livrohet, dhe Blerësi do të programojë, blejë dhe pranojë, ose do të bëjë të mundur të pranohet Sasia e Kontratës sipas programit të deklaruar për ditën në avancë; dhe Blerësi do t'i paguajë Shitësit Çmimin përkatës të Kontratës.
3. **Përkufizimi i Programit:** "Program" sipas zbatimit, do të thotë veprimet e nevojshme për një Palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit ose pranimit, që mund të përfshijnë nominimin, programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, agjentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar përkatës, dhe me OST-në, kur aplikohet, Sasinë e Kontratës, Kapacitetin e Kontratës, Pikën e Livrimit, Programin e Livrimit, Periudhën Totale të Furnizimit, dhe çdo kusht tjetër përkatës të Kontratës sipas gjithë rregullave të zbatueshme të OST-së dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.

**NENI 7
LIVRIMI, MATJA, TRANSMETIMI DHE RISKU**

1. **Rryma/Frekuenca/Tensionet:** Energjia Elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në Pikën përkatëse të Livrimit sipas standarteve të OST-së dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, kur aplikohet, si dhe në përputhje me Rregullat dhe Kodet në fuqi.
2. **Programet e Deklaruara:** Sasia e Energjisë Elektrike që do të programohet dhe konfirmohet nga Shitësi për Blerësin, do t'i livrohet këtij të fundit mbi baza ditore dhe orare në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi. Nominimi fizik/programi për ditën e nesërme duhet paraqitur në oraret në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi.
3. **Rimbursimi i Kostove të Jashtme:** Në rast se njëra Palë, me kërkesën e Palës tjetër ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga Pala tjetër, pëson shpenzime të jashtme të arsyeshme, kur verifikon se Pala tjetër nuk i ka kryer si duhet detyrimet e saj sipas kushteve të Kontratës, këto shpenzime do të rimbursohen me kërkesën e Palës që ka dështuar në performim.
5. **Risqet e Shitësit dhe Blerësit:** Shitësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, transmetimit dhe livrimit të Sasisë së Kontratës deri në Pikën e Livrimit. Blerësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, pranimit dhe transmetimit të Sasisë së Kontratës në dhe nga Pika e Livrimit.
6. **Pikat e Livrimit:** Shitësi do ta livrojë energjinë elektrike në hyrje të sistemit të transmetimit të OST, me kusht që të ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.



NENI 8 MOS-PERFORMANCA PËR SHKAK TË FORCËS MADHORE

1. **Përkufizimi i Forcës Madhore:** Përveç se kur specifikohet ndryshe, "Forcë Madhore" për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala Pretenduese"), siç përcaktohet në Ligjin nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimin, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - a) defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimin; ose
 - b) pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimin ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
2. **Çlirimi nga Detyrimet e Livrimit dhe Pranimin:** Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas një ose më shumë Kontratave dhe kjo Palë respekton kërkesat e pikës 3 të këtij neni (Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore), do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas nenit 9 (Zhdëmtimet/kompensimet) nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasinë e palivruara ose të pamarra.
3. **Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore:** Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimin të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
4. **Efektet e Forcës Madhore mbi Palën Tjetër:** Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimin dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimin për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.

NENI 9 ZHDËMTIMET/KOMPENSIMET

1. **Rasti i mos-performancës ana e shitësit:** Në atë shkallë që Shitësi - Pala që ka detyrimin për livrimin e energjisë elektrike ("Pala Livruese") nuk i livron tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë të përcaktuar/rakorduar për ditën në avancë, dhe kjo paaftësi nuk shfajësohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mosperformanca e Palës tjetër, Pala Livruese do t'i paguajë Palës tjetër ("Pala Pranuese") një shumë kompensimi për sasinë e palëvruar të energjisë elektrike e barabartë me shumën që do të paguajë blerësi si përgjegjës për disbalancat e shkaktuara nga moslëvrimi.
2. **Rasti i mosrespektimit nga ana e blerësit:** Në rastin kur Blerësi ("Pala Pranuese") dështon të pranojë tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë elektrike të rakorduar për ditën në avancë dhe kjo paaftësi nuk shfajësohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mos-performanca e Palës tjetër, Pala pranuese do t'i paguajë Palës tjetër ("Pala Livruese") një shumë kompensimi



të barabartë me diferencën midis kostos mesatare të importit të energjisë të siguruar nga pala livruese në periudhën e mos përmbushjes (por jo më shumë se vlera e energjisë në HUPX për periudhën e mos përmbushjes) dhe kompensimit që pala shitëse krijon sipas rregullave të balancimit, në rastin kur kjo diferencë është pozitive.

3. Palët rakordojnë mes tyre sasinë faktike të energjisë së livruar dhe pranuar për qëllime të aplikimit të kompesimeve si më sipër.
4. **Shuma e pagueshme:** shumat e pagueshme sipas këtij neni do të faturohen dhe paguhën sipas Nenit 11 (Faturimi dhe pagesa).

NENI 10 KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË FINANCIARE

1. **Përjashtimi i Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikave 13.2 dhe 13.3 dhe përveç kur lidhet me shumat e pagueshme sipas Nenit 9 (Zhdëmtimet), një Palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, kontraktorët dhe/ose agjentët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj Palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm ("Dëmet"), (përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një Kontrate Individuale) që pëson Pala tjetër sipas Marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto Dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mospagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një Pale ose punonjësve, zyrtarëve, kontraktorëve dhe/ose agjentëve të saj, përdorur nga kjo Palë për përmbushjen e detyrimeve të saj sipas Kontratës.
2. **Dëmi Pasues dhe Kufizimi i Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikës 13.3, përgjegjësia ligjore e një Pale sipas Kontratës ose lidhur me të:
 - (a) nuk përfshin përgjegjësinë financiare për Dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të parashikuara; dhe
 - (b) kufizohet me një shumë të barabartë me shumat e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një Palë sipas çdo Kontrate Individuale përkatëse me kusht që ky kufizim të mos zbatohet për pagesat sipas pikës 9 (Zhdëmtimet për Paaftësinë për Livrim dhe Pranim).
3. **Mospagesa e Qëllimshme, Mashtrimi dhe të Drejtat Themelore:** Asgjë në Marrëveshje nuk vepron për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë ligjore të Palës për:
 - (a) mospagesën e qëllimshme,
 - (b) mashtrimin; ose
 - (c) çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një Pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një Pale.
4. **Detyrimi për Lehtësimin e Humbjeve:** Për shmangien e dyshimit, dhe subjekt i legjislacionit në fuqi, çdo Palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë Dëmet dhe premtan se do të bëjë përpjekje komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo Dëmi që mund të pësojë sipas Kontratës ose lidhur me të.

NENI 11 FATURIMI DHE PAGESA

1. **Fatura:** Shitësi në bazë të Raportit të Vlefshëm do t'i dorëzojë Blerësit për livrimin e Energjisë Elektrike një faturë sipas formatit dhe standardeve që kërkon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasinë totale të Energjisë Elektrike të shitur prej tij në periudhën kohore të lëvrimit të miratuar në Aneksin përkatës të kësaj kontrate. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e fundit e livrimit të energjisë elektrike. (ose kur kjo datë është



- pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës). Kur periudha kohore e prokurimit të energjisë elektrike është më e gjatë se 1 muaj, faturimet do të kryhen pas çdo periudhe lëvrimit, me bazë mujore. Krahas faturës, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit edhe Raportin e Vlefshëm.
2. **Raporti i Vlefshëm:** Blerësi, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e fundit e periudhës kohore të livrimit sipas parashikimit të të njëjtit Aneks, duhet t'i dorëzojë shitësit një raport të nënshkruar për energjinë e dërguar për këtë periudhë (në vazhdim raporti) që të përmbajë të dhëna për planet e rakorduara ditore sipas kësaj Marrëveshjeje. Në rast se ka kontestime, Shitësi mund t'i paraqesë Blerësit një ankim për raportin lidhur me saktësinë e të dhënave, brenda 2 (dy) ditëve nga dita që Blerësi, i ka dorëzuar raportin. Nëse Blerësi, e konsideron ankimin të justifikuar ligjërisht, do të nxjerrë një raport të ri. Në rast se ankimi konsiderohet i pajustificuar ligjërisht, Blerësi, do të njoftojë shitësin brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e ankesës, duke vazhduar me procesin e faturimit në përputhje me raportin e vlefshëm.
 3. **Pagesa:** Blerësi do t'i kryejë pagesën Shitësit kundrejt vlerës së faturës sipas pikës 1. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.
 4. **Vonesa në kryerjen e pagesës:** Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, penalteti për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të llogaritet në përputhje me Ligjin Nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" (i ndryshuar)".

NENI 12 TVSH-JA DHE TAKSAT

1. **TVSH-ja:** Të gjitha shumat e referuara në këtë Kontratë përjashtojnë çdo vlerë të zbatueshme të taksës së shtuar ("TVSH"). Nëse TVSH-ja është e pagueshme për çdo shumë të tillë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një shumë të barabartë me TVSH-në me tarifën e zbatueshme. Një shumë e barabartë me TVSH-në e pagueshme nga një Palë do të kërkohej për t'u paguar vetëm kur Pala tjetër të sigurojë një faturë të vlefshme TVSH-je lidhur me atë shumë. Çdo Palë, për aq sa e lejon ligji, do t'i sigurojë palës tjetër fatura TVSH-je shtesë të vlefshme që kërkohej për qëllimet e Kontratës.
2. **Detyrimet e Taksave të Shitësit dhe Blerësit:** Shitësi do të paguajë ose sigurojë pagesën e gjithë Taksave për Sasinë e Kontratës ose lidhur me të që del para transferimit të riskut dhe titullit në Pikën e Livrimit. Blerësi do të paguajë ose do të kryejë pagesën e gjithë Taksave në Sasinë e Kontratës ose lidhur me të që dalin gjatë ose pas transferimit të riskut dhe titullit në Pikën e Livrimit (përveç Taksës direkte ose indirekte që lidhet me shitjen e Sasisë së Kontratës dhe është përgjegjësi ligjore e Shitësit). Në rast se Shitësit i kërkohej me ligj të paguajë çdo Taksë të përshtatshme për llogarinë e Blerësit, Blerësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë Shitësin për këtë Taksë. Në rast se Blerësit i kërkohej me ligj të paguajë çdo Taksë të përshtatshme për llogarinë e Shitësit, Blerësi mund të kërkojë nga shitësi ta zbresë shumën e kësaj Taksë nga shumat që i detyrohet Shitësit sipas Kontratës, në të kundërt Shitësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë Blerësin lidhur me këto Taksa të pazbritura. Nëse ndonjë Taksë e re bëhet e zbatueshme ose një Taksë ekzistuese rritet lidhur me Kontratën dhe Blerësi është në gjendje ta kalojë përmes një pale të tretë, Blerësi do të jetë përgjegjës për këtë Taksë të re ose të rritur.
3. **Taksa e Mbajtur:** Pagesat Lirë dhe Qartë. Gjithë pagesat sipas Kontratës do të bëhen pa mbajtje ose zbritje për llogari të çdo Takse përveç kur kjo mbajtje ose zbritje kërkohej me ligj. Nëse një Pale i kërkohej të mbajë ose zbresë Taksën nga një pagesë që duhet të bëjë, atëherë ajo Palë ("Pala Paguese") do të njoftojë menjëherë Palën tjetër ("Pala Marrëse") për këtë kërkesë dhe do t'u paguajë autoriteteve të duhura gjithë shumat e mbajtura ose të zbritura prej



saj. Nëse mund të lëshohet një faturë ose provë tjetër që evidenton pagesën tek autoritetet, Pala Paguese do t'ia dorëzojë këtë provë (ose një kopje të certifikuar) Palës Marrëse.

4. **Minimizimi i Taksave:** Të dyja Palët do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të administruar Kontratën dhe për të zbatuar dispozitat e saj sipas synimit për minimizimin e akumulimit të detyrimeve për pagesën e Taksës, kur është e arsyeshme dhe e mundur.

NENI 13 TRANSFERIMI

1. **Ndalimi:** Asnjëra Palë nuk do të autorizohet që t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës një pale të tretë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme, dhe me miratimin e ERE-s.
2. **Transferimi tek Filialet:** Çdo Palë do të autorizohet t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, një Filiali me aftësi paguese të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër dhe, me kusht që çdo Dokument Mbështetës Kredie i nxjerrë ose i vendosur në emër të Palës transferuese të jetë rinxjerrë ose amenduar fillimisht për të mbështetur detyrimet e Filialit në përfitim të Palës tjetër.

NENI 14 PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

1. Secila palë përfaqëson dhe garanton Palën tjetër, pas hyrjes në këtë Kontratë, për sa vijon:
 - a. se është një Njësi e organizuar si duhet, që ekziston në mënyrë të arsyeshme dhe sipas ligjeve të juridiksionit të korporatës ose organizatës;
 - b. nënshkrimi dhe hyrja në Kontratë, në çdo Dokument Mbështetës Kredie ku është palë dhe në kryerjen e transaksioneve të shqyrtuara këtu, nuk do të shkelin asnjë dispozitë ligjore në fuqi;
 - c. ka pushtetin dhe është e autorizuar të ekzekutojë, shpërndajë dhe kryejë detyrimet sipas kontratës ku është palë dhe ka ndërmarrë gjithë veprimet e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin, livrimin, kryerjen dhe hyrjen në Kontratë dhe ekzekutimin, livrimin dhe kryerjen e Kontratës dhe se çdo Dokument Mbështetës nuk shkel dhe nuk bie në konflikt me asnjë afat ose kusht tjetër të ndonjë kontrate ku është palë ose ndonjë akt ligjor dhe nënligjor në fuqi;
 - d. ka gjithë autorizimet qeveritare dhe rregullatore, miratimet dhe pëlqimet e nevojshme për të kryer detyrimet sipas Kontratës ku është palë; e ka negociuar, ka hyrë dhe ka ekzekutuar Kontratën ku është palë si kryesore (dhe jo si agjent ose me ndonjë kapacitet tjetër, kujdestar apo ndryshe);
 - e. vepron për llogari të vet (dhe jo si këshilltar, agjent, agjent ndërmjetës ose me ndonjë kapacitet tjetër, kujdestar apo ndryshe), ka marrë vendimin e vet të pavarur për të hyrë në këtë Kontratë dhe nëse kjo Kontratë është e përshtatshme ose si duhet për të, bazuar në gjykimin e vet, nuk mbështetet mbi këshillën ose rekomandimet e Palës tjetër për ta bërë këtë, dhe është e aftë për të vlerësuar meritat dhe kupton dhe pranon afatet, kushtet dhe risqet e Kontratës;
 - f. pala tjetër nuk vepron si kujdestar apo këshilltar i saj;
 - g. nuk mbështetet në asnjë përfaqësim të bërë nga Pala tjetër përveç atyre të thëna shprehimisht në Kontratë;
 - h. lidhur me një Palë që është entitet shtetëror ose sistem energjetik publik, kjo Njësi qeveritare ose sistem energjetik publik përfaqëson dhe i garanton Palës tjetër si më poshtë:



- (i) gjithë aktet e nevojshme për ekzekutimin e vlefshëm, shpërndarjen dhe zbatimin e Kontratës, përfshirë pa kufizim, ofertat konkurruese, njoftimin publik, zgjedhjen, përvetësimin paraprak ose procedura të tjera të kërkuara që janë ndërmarrë ose kryer ose do të ndërmerren dhe kryhen;
 - (ii) hyrja në Kontratë dhe zbatimin e saj nga një Njësi qeveritare ose sistem energjetik publik bëhet për një qëllim të duhur publik brenda kuptimit të legjislacionit në fuqi; dhe
 - (iii) afati i Kontratës nuk zgjatet përtej ndonjë kufizimi të zbatueshëm të vendosur nga ndonjë dokument tjetër dhe/ose nga legjislacioni në fuqi; dhe
- m. lidhur me një Palë, se nuk ka falimentuar, dhe nuk ka procedime ligjore ose administrative pezull ose kërcënuese ku të jetë palë dhe që në dijeni të saj do të ndikojnë materialisht në mënyrë të dëmshme në aftësinë e saj për përmbushjen e çdo detyrimi sipas kësaj Kontrate ose ndonjë Dokumenti Mbështetës të Kredisë ku është palë, të tilla që ta bëjnë të falimentonte.

NENI 15

LEGJISLACIONI NË FUQI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- Legjislacioni në Fuqi:** Kjo Kontratë është hartuar në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me të.
- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve:** Çdo mosmarrëveshje që ngrihet si pasojë e interpretimit dhe zbatimit të kësaj Kontrate apo Aneksëve të nënshkruara nga palët pas çdo procedure blerjesh të zhvilluar, Palët do të mundohen t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre dhe kur kjo është e pamundur, secila prej palëve ka të drejtë që brenda 5 ditëve pune ta adresojë mosmarrëveshjen për zgjidhje në ERE. Secila palë mund t'i drejtohet Gjykatës për shqyrtimin gjyqësor të mosmarrëveshjeve.

NENI 16

PERSONAT E KONTAKTIT

Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me email ose faks:

Për OST	Për KESH
Administratori i Kontratës	
Z/Znj Griselda Merkaj Funksioni Drejtor i Drejtoris së Shërbimeve të Tregut Adresa Autostrada Tiranë- Durrës KM 9 Yrshek ,Kashar, Tiranë Tel.: + 355 422 25 581 Mob:+ 355 69 60 10 492	Z/Znj Erald Elezi Funksioni Drejtor i Departamentit te Operimit dhe Tregtimit Adresa “Blloku Vasil Shanto”, Tirane Tel.: + 355 422 41 981 Mob:+ 355 69 70 98 777
Fax: + 355 422 25 581 E-mail: g.merkaj@ost.al	Fax: + 355 4 22 32 046 E-mail: elezie@kesh.al



Programi	
Z/Znj _Alban Qurku Funksioni Përgjegjës I Operacioneve Balancuese dhe Ndërkufitare Adresa Autostrada Tiranë- Durrës KM 9 Yrshek, Kashar, Tiranë Tel.: + 355 422 25 581 Mob:+ 355 69 866 6680 Fax: + 355 422 25 581 E-mail:a.qurku@ost.al	Z/Znj Aurora Bego Funksioni Shefe Sektorit te Transaksioeneve Tregtare Adresa “Blloku Vasil Shanto”, Tirane Tel.: + 355 422 41 981 Mob:+ 355 67 21 35 152 E-mail: scheduling@kesh.al
Back Office	
Z/Znj Migena Vako Funksioni Specialiste pranë Sektorit të Operacioneve Balancuese dhe Ndërkufitare Adresa Autostrada Tiranë- Durrës KM 9 Yrshek ,Kashar , Tiranë Tel.: + 355 422 25 581 Mob:+ 355 69 252 7030 Fax: + 355 422 25 581 E-mail: m.vako@ost.al	Z/Znj Artan Gjonca Funksioni Shef Sektori I Administrimit te Kontratave Adresa “Blloku Vasil Shanto”, Tirane Tel.: + 355 422 41 981 Mob:+ 355 68 60 25 827 E-mail: backoffice@kesh.al

NENI 17 TË NDRYSHME

- Njoftimet dhe Komunikimet:** Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga Palët, të gjitha njoftimet, deklaratat ose faturat e dërguara nga një Palë tjetër, duhet të jenë me shkrim dhe duhen dorëzuar me letër (postë që arrin brenda 24 orësh ose korrier, postë e parapaguar) ose faksimile. Çdo Palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:
 - nëse shpërndahen dorazi Ditën e Punës, ose Ditën e parë të Punës pas datës së livrimit nëse shpërndahen jo në Ditën e Punës;
 - nëse dërgohen me postë të shpejtë, Ditën e 2 të Punës pas datës së postimit, ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në Ditën e 5 të Punës pas datës së postimit;
 - nëse dërgohen me transmetim faksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që konfirmon marrjen, ditën e transmetimit nëse është transmetuar para orës 17.00 (me orën e marrësit) në Ditën e Punës ose në orën 09.00 (me orën e marrësit) në Ditën e parë të Punës pas transmetimit.
- Amendimet:** Çdo amendim ose shtesë në këtë Kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët.



3. **Pavlefshmëria e Pjesshme:** Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Kontrate, nuk do të preken ose dëmtohen në ndonjë mënyrë. Palët ndërmarrin zëvendësimin e çdo dispozite të paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme me një dispozitë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme që afrohet sa më shumë me dispozitën e pavlefshme lidhur me qëllimin e saj ekonomik, subjekt i aprovimit sipas pikës 2 të këtij neni.
4. **Të Drejtat e Palës së Tretë:** Palët nuk presin që ndonjë palë e tretë të ketë të drejta ose të jetë e aftë të zbatojë Kontratën dhe Palët përjashtojnë për aq sa është e lejueshme nga legjislacioni në fuqi, çdo të drejtë të këtyre palëve të treta që mund të nënkuptohet.

NENI 18**MIRATIMI I ERE-S, HYRJA NE FUQI, EFEKTET DHE ZGJIDHJA E PARAKOHSHME**

1. Kjo Kontratë, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga Bordi i ERE dhe i shtrinë efektet për periudhën 02.07.2022 – 31.12.2022.
2. Kjo kontratë mund të ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së përfundimit të saj, vetëm me miratimin e ERE.

NENI 19

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.

Për
**KOORPORATËN
ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE,
KESH SH.A.**

ADMINISTRATORI

Ergys VERDHO



Për
**OPERATORI I SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT,
OST SH.A.**

ADMINISTRATORI

Skërdi DRENOVA





Aneks 1

Raport –Rakortimi

Ndërmjet shoqërive:

Me datë ____/____/2022, KESH sh.a. ka levruar dhe OST sh.a. ka pranuar energjinë elektrike sipas raportit të mëposhtëm:

Data/ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	TOTALE
01/ /2022																									
02/ /2022																									
03/ /2022																									
04/ /2022																									
05/ /2022																									
06/ /2022																									
07/ /2022																									
08/ /2022																									
09/ /2022																									
10/ /2022																									
11/ /2022																									
12/ /2022																									
13/ /2022																									
14/ /2022																									
15/ /2022																									
16/ /2022																									
17/ /2022																									
18/ /2022																									
19/ /2022																									
20/ /2022																									
21/ /2022																									
22/ /2022																									
23/ /2022																									
24/ /2022																									
25/ /2022																									
26/ /2022																									
27/ /2022																									
28/ /2022																									
29/ /2022																									
30/ /2022																									
31/ /2022																									
TOTALE																									

Konfirmuar nga KESH:

(emër, mbiemër, firmë)

Konfirmuar nga OST:

(emër, mbiemër, firmë)



Aneks 2
i Kontratës për shit-blerjen e Energjisë Elektrike për Mbulimin e Humbjeve në Rrjetin e
Transmetimit
Ndërmjet shoqërive:
Kontrate Individuale

Referenca e Kontratës: _____

Shitësi: KESH sh.a.

Blerësi: OST sh.a.

Fillimi i levrimit	Mbarimi i levrimit	Sasia e levruar (MWh)	Cmimi i shitjes (Leke/MWh)	Vlera Totale (Leke)

Tipi I kontratës: Me cmime fikse.

Zona lokale: GMT +1 (CET, Koha lokale Shqiptare)

Pika e levrimit: ALB-ALB

Kushtet e kontratës:

Ky konfirmim konfirmon kontratën individuale të lidhur në përputhje me kontratën bazë për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin humbjeve në sistemin e transmetimit, lidhur me dërgimin dhe pranimin e energjisë elektrike.

KESH sh.a

Emri:

Titulli:

OST sh.a

Emri:

Titulli:



VENDIM
Nr. 231, datë 12.9.2022

**MBI SHTYRJEN E VENDIMARRJES
SË BORDIT PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË OST SHA PËR
TRANSFERIMIN E ASETEVE TË
INVESTIMIT TË KRYER NGA ZBATIMI
I PROJEKTIT “SUPPLY AND
INSTALATION OF TRANSMISSION
METER/DATA CENTER” NGA OST SHA
TEK OSHEE GROUP SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1528 prot., datë 8.9.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit ‘Supply and instalation of transmission meter/data center’ nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 174, datë 7.7.2022, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/Data Center”, nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.

- Në vijim të këtij vendimi, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174/2022, si dhe duke i kërkuar depozitimin e listës së detajuar të aseteve që do të transferohen dhe përcjelljen e një informacioni shtesë, në lidhje me plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje, që do të jenë në funksion të realizimit të transferimit të Aseteve tek Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. Lidhur me këtë transferim, shoqëria duhet të sqaronte nëse këto investime janë të OST sh.a. dhe do t'i transferohen Operatorit të

Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. apo janë vetëm për efekt të vlerave të investimeve, që të njihen si kosto e OSSH sh.a.

- Meqenëse dokumentacioni i protokolluar në ERE nga OST sh.a. me shkresën nr. 944/2, është depozituar më datë 6.9.2022 dhe duhet të analizohet nga ERE në kuptim edhe të bazës ligjore, në lidhje me këtë transferim për të dalë me një vendim përfundimtar, vlerësohet e nevojshme shtyrja e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e OST sh.a. për transferimin e aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of transmission meter/data center” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.

- “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, në nenin 10, “Afati i shqyrtimit të kërkesës”, në pikën 1 të tij parashikon, se:

“1. Shqyrtimi i kërkesës për transferimin e aseteve, nëse i licencuari ka plotësuar tërësisht informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, do të bëhet brenda 45 ditëve pune nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit.”.

- Në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me qëllim sqarimin e konstatimeve të mësipërme, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë kalendarike e vendimarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and instalation of transmission meter/data center”, nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and instalation of transmission meter/data center”, nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 232, datë 12.9.2022

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
LICENCIMIT TË SHOQËRISË
“BREÇANI R.O.S.P.” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“DRITA” ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1980 kw**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 144/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1528/1 prot., datë 8.9.2022, “Mbi një ndryshim në vendimin e licencimit të shoqërisë ‘Breçani R.O.S.P.’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Drita’, me kapacitet të instaluar 1980 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 09, datë 21.1.2022, ka licencuar shoqërinë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Drita”, për një afat 30-vjeçar. Ndër të tjera ky vendim përcakton kushtet, si vijon:

“2. Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. duhet të paraqesë në ERE çdo vit kontratën nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të rinovuar, brenda datës 18 gusht të çdo viti, deri në përfundim të afatit 10- vjeçar që ajo përcakton.

4. Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. të depozitojë në ERE certifikatën e pronësisë për tokën shtet, me kartelën shoqëruese, me shënimin përkatës për zonën që do të jetë në përdorim të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së HEC “Drita”, jo më vonë se një muaj nga pajisja me këtë dokument.”.

- Në kuadër të plotësimit të këtyre kushteve, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 37/3 prot., datë 28.7.2022, duke i kërkuar informacion.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 37/4, datë 4.8.2022, ka përcjellë shkresën me të cilën i është drejtuar Bashkisë Tropojë, në lidhje me mosrinovimin e kontratës së qirasë për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullësor, për arsye se shoqëria ka përmbushur gjithë detyrimet kontraktore.

- Po ashtu, shoqëria ka bërë me dije se gjurma e projektit të hidrocentralit shtrihet në dy zona kadastrale me nr. 1133, fshati Begaj, dhe nr. 3404, fshati Shoshan, Bashkia Tropojë, në pasuritë me status juridik shtet.

- Për gjithë sa më sipër, duke qenë se nuk njihemi ende me ndonjë komunikim të Bashkisë Tropojë, në lidhje me përfundimin e kontratës së qirasë për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullësor, nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të lidhur ndërmjet Bashkisë Tropojë në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, me objekt lejimin e hapjeve të kanaleve, shtrirjen e tubacionit dhe të drejtën e kalimit dhe përdorimit në funksion të ndërtimit të HEC “Drita”, me qëllim për të sqaruar çështjen e rregullimit pronësor në tërësi, vlerësojmë që afati i parashikuar në pikën 2 të vendimit të licencimit nr. 09, datë 21.1.2022, të ndryshohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 9, datë 21.1.2022, ndryshon si vijon:

“2. Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. duhet të paraqesë në ERE kontratën nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të rinovuar, apo çdo dokument tjetër që i shërben realizmit të saj brenda 30 ditëve pune nga marrja dijëni.”.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESE

Shtetasi Leonard Abazi kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë shpalljen e vdekjes së shtetasit Pashk Mark Abazi, i ditëlindjes 4.12.1991, i lindur në fshatin Mëzi, Fierzë, dhe i vdekur më datë 22 shkurt 2014.

KËRKUES
Leonard Abazi

NDREQJE GABIMI

Tabelat e munguara të aneksit nr. 2 të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 95, datë 9.5.2022, “Për miratimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 78, datë 24.5.2022

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E MATERIALEVE KALLËZUESE TË MOSFILLUARA TË PROKURORIT _____ TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ /GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/GJYKATËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____

[illegible]

ANEKSI NR. 2

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇESHTJEVE KËRKESË PUSHIMI (KRIME) TË PROKURORIT _____ TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ /GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/GJYKATËS KUNDER KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____

[illegible]



ANEKSI NR. 2

Tabela nr. 3

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE VENDIM PUSHIMI (KUNDËRVAJTJE PENALE) TË PROKURORIT _____ TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ / GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/ GJYKATËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____																		
Nr.	Kallëzimi		Data e shortit elektronik	Numri dhe data e regjistrimit të procedimit penal				Vepra/t penale e regjistruara	Data e vendimit të zëvendësimit nëse çështja është marrë nga një prokuror tjetër	Data e vendimit të pushimit të proc. penal	Datë e dorëzimit në sekretari të vendimit për pushim (nëse ka)	Kohëzgjatja në hetim		Krahasuar me afatin ligjor	Numri i zgjatjeve	Me masë sigurimi, lloji i masës.	Ankim i prokurorit ndaj vendimit të gjykatës (nëse ka)	Transf. i përkoh. ose i caktuar i përkoh. në prok. tjetër
	nr.	datë		me autor		pa autor						me autor	pa autor					
				nr.	datë	nr.	datë											
																		</

ANEKSI NR. 2

Tabela nr. 4

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE TË DËRGUARA NË GJYKIM, TË PROKURORIT _____ TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ /GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/ GJYKATËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____																		
Nr.	Kallëzimi		Data e shortit elektronik	Numri dhe data e regjistrimit të proc. penal		Vepra/t penale e regjistruar	Data e vendimit të zëvendësimit nëse çështja është marrë nga një prokuror tjetër	Natyra e çështjes/data e kërkesës				Datë e dorëzimit në sekretari të kërkesës	Kohëzgjatja në hetim	Krahasuar me afatin ligjor	Numri i zgjatjeve	Me masë sigurimi, lloji i masës	Ankim i prokurorit ndaj vendimit të gjykatës (nëse ka)	Transf. i përkoh. ose i caktuar përkoh. në prok. tjetër
	nr.	datë		nr.	datë			Marrëveshje	Urdhër penal	Gjykimi i drejtpërdrejt	Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq							
													Koha mesatare e hetimit	Krahasuar me kohën mesatar të hetimit të seksionit/prokurorisë				

Tabela nr. 5

[illegible]

ANEKSI NR. 2

Tabela nr. 6

[illegible]



ANEKSI NR. 2

Tabela nr. 7

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E URDRHAVE TË EKZEKUTIMIT, TË PROKURORIT _____ TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ /GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/ GJYKATËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____													
N r.	Data e hyrjes në sekretarinë e prokurorisë të vendimit të gjykatës	Data e marrjes në dorëzim nga prokurori nëse ka	Urdhri i ekzekutimit		Vendimi penal i formës së prerë						Datë e dorëzimit në sekretari të urdhrat	Kohëzgjatja e fazës së nxjerrjes së urdhrat të ekzekutimit	Krahasuar me afatin ligjor
			Nr.	Datë	Dënim kryesor (burgim /gjobë)	Dënim Plotësues (neni)	Dënime alternative (neni)	Pagim shumës së të hollave, pranimit pagimit të gjobës, Bashkim dënimesh (neni)	Të tjera (shpenzime procedurale, disponim për provat materiale etj.)	Masë Mjekësore/edukuese			

ANEKSI NR. 2

Tabela nr. 8

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE HETIME PASURORE, TË PROKURORIT _____ TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ / GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/GJYKATËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____														
Nr.	Referimi pasuror		Data e shortit elektronik	Mosfillim i referimit pasuror	Kohëzgjatja e vendimarrjes	Numri dhe data e regjistrimit të proc. pasuror		Kërkesë për sekuestrim (datë)	Pushim i procedimit pasuror-data	Kërkesë për konfiskim (data)	Kohëzgjatja nga sekuestrimi deri në paraqitjen e kërkesës për konfiskim	Krahasuar me afatin ligjor	Ankim i prokurorit ndaj vendimit të gjykatës (nëse ka)	Transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht në prokurori tjetër
	nr.	datë				Nr.	Datë							
											Koha mesatare e hetimit	Krahasuar me kohën mesatar të hetimit të seksionit/prokurorisë		



ANEKSI NR. 2

Tabela nr. 9

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE MARRËDHËNIE JURIDIKSIONALE ME JASHTË, TË PROKURORIT _____ TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ /GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/GJYKATËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____																	
Nr.	Nr. i materialit protokolli	Data e regj. në prokurori	Data e shortit	Ekstradim për jashtë shtetit						Ekstradim nga jashtë shtetit, Urdhri i kërimit ndërkombëtar		Letërporosi nga jashtë shtetit			Njohja e vendimit penal të huaj		
				Kërkesë për arrestim të përkohshëm me qëllim ekstradimi	Vendim i gjykatës	Ankimuar	Kërkesë për ekstradim	Vendimi i gjykatës	Ankimuar	nr.	datë	Ekzekutuar drejtpërdrejt nga prokurori (data e përcjelljes së praktikës)	Me kërkesë drejtuar gjykatës (data e përcjelljes së praktikës)	Kohëzgjatja e ekzekutimit	Kërkesa drejtuar gjykatës	Vendimi i gjykatës	Ankimuar

ANEKSI NR. 2

Tabela nr. 10

TABELA PËR VOLUMIN E ÇËSHTJEVE TË PËRFUNDUARA NË GJYKIM, TË PROKURORIT _____ TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ / GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/GJYKATËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____														
Nr.	Numri dhe data e regjistrimit të proc. penale		Vepra/t penale dërguara për gjykim	Me masë sigurimi, lloji i masës.	Lloji i gjykimit		Konkluzionet e prokurorit			Vendimi i gjykatës			Ankim i prokurorit ndaj vendimit të gjykatës (nëse ka)	Transf. i përkoh. ose i caktuar përkoh. në prok. tjetër
	nr.	datë			i shkurtuar	i zakonshëm	Lloji i dënimit	Masa	Pafajësi/ pushim	Lloji i dënimit	Masa	Pafajësi/ pushim		



ANEKSI NR. 2

Tabela nr. 11

TABELA PËR VOLUMIN E ÇËSHTJEVE KËRKESA QË I PËRKASIN FAZËS SË EKZEKUTIMIT, TË PROKURORIT _____ TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ / GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/ GJYKATËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____										
Nr.	Kërkesa e prokurorit		Objekti i kërkesës (neni)	Kërkesa e të dënuarit		Vendimi i gjykatës			Ankim i prokurorit ndaj vendimit të gjykatës (nëse ka)	Transf. i përkoh. ose i caktuar i përkoh. në prok. tjetër
	nr. prot.	datë		Objekti i kërkesës (neni)	Qëndrimi i Prokurorit pranimin/ rrëzimin	nr.	datë	pranim/ rrëzim		

ANEKSI NR. 2

Tabela nr. 12

TABELË PËRMBLEDHËSE, ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR RENDIMENTIN E PROKURORIT _____ TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ /GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/GJYKATËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____																				
Viti i vlerësimit	Çështje të mbartura nga viti paraardhës	Çështje të regjistruara gjatë vitit të vlerësimit	Hetime pasurore	Totali i çështjeve të hetuara gjatë vitit të vlerësimit	Çështje të përfunduara								Totali i procedimeve të përfunduara gjatë vitit të vlerësimit	Kallëzime		Totali i çështjeve të trajtuara (procedime+ mosfilime+ kallëzime)	Totali i çështjeve të përfunduara (procedimi + mosfilime)	Rendimenti	Rendimenti i prokurorisë/ seksionit	Rendimenti i prokurorit krahasuar me rendimentin e prokurorisë/seksionit
					Kërkesë Dërgimi Gjyqit	Marrëveshje	Urdhër Penal	Pezullim	Kompetencë	Pushim	Kërkesë Për pushim	Kërkesa për konfiskim		Mosfilime	Kallëzime për verifikim (mbartur në vitin pasardhës)					



ANEKSI NR. 2

Tabela nr. 13

TABELË PËRMBLEDHËSE, ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR PËRJASHTIMET DHE HEQJET DORË PËR PROKURORIN NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____ / GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË/GJYKATËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË PËR VITIN _____								
	Natyra e çështjes		Kërkesa për përjashtim/zëvendësimin e prokurorit	Pranuar	Refuzuar	Heqje dorë	Pranuar	Refuzuar
Nr. rendor	Nr. kallëzimi	Datë						
Nr. rendor	Nr. procedimi (me autor të njohur)	Datë						
Nr. rendor	Nr. Procedimi (pa autor)	Datë						
Nr. rendor	Lloji i praktikës (nr. prot/nr. urdhër ekzekutimi/etj.)	Datë						

**NDREQJE GABIMI MATERIAL**

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 75, datë 13.4.2022, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2021”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 65, datë 29.4.2022:

Emërtimi i titullit ndryshon si më poshtë vijon:

“Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2022”

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 76, datë 13.4.2022, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2021”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 65, datë 29.4.2022:

Emërtimi i titullit ndryshon si më poshtë vijon:

“Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2022”

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 13.4.2022, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2021”:

Emërtimi i titullit ndryshon si më poshtë vijon:

“Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2022”

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë